



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2546 Prot.

Roskovec, më 01.04 2021

VENDIM

NR 13 .DATË 31.03 .2021

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN SHKURT 2021”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 26.02.2021, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Shkurt 2021.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 1587/1 Prot.

Roskovec, më 01.03.2021

Procesverbal Nr.2

-I mbajtur sot, date 26.02.2021, ora 11, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite si me poshte :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Janar 2021.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Janar 2021.
5. Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2022-2024”.
6. Për një ndryshim në Vendimin Nr.68 datë 28.08.2020 “Për shpronësimin, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec”.
7. Për miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapsirës publike në Bashkinë Roskovec”.
8. Për miratim dhe transferim fondesh në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2021.
9. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11⁰⁰

Keshilltaret prezent: V. Mata, E. Çepele, L. Goga, B. Çobo, B. Kuka, D. Hoxha, K. Hyska, G. Hoxha, A. Hazi zi, V. Dogani, V. Stani, H. Beqiraj, B. Toska, M. Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : A. Kola, K. Kuka, Rr. Hazizi, L. Hoxha, T. Kuka, V. Bakaj, A. Sheme.

Prezent nga administrata e bashkise: Kryetarja e bashkise, Dr. Juridike, Dr. Tatim-Taksave, juriste e urbanistikes, Dr. Finances, P/Z/Ndihmes Ekonomike, E. Zenelaj mentore e keshillit nga Bashki te Forta, qytetari M. Ngjeqari.

Me plotesimin e kuorumit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 14 keshilltare. Kryetari i Keshillit fillon mbledhjen.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites se sotme dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Janar 2021.

Sekretarja e keshillit sqaron informacionin.Sqaron vendimet dhe zbardhjen e tyre.Kishim 3 vendime normative te cilat i derguam ne Prefekture.Keto vendime jane miratuar nga Prefektura.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

4.Per dhenien e Ndiemes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Janar 2021.

Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

5.Per miratimin e raportit te vleresimit dhe parashikimit afatmesem te te ardhurave 2022-2024.

Dr.tatim-taksave sqaron raportin e vleresimit dhe parashikimit afatmesem te te ardhurave 2022-2024.Sqaron me detaje gjithë raportin sipas materjalit te paraqitur.Leksi-te shtresat e tjera ne lidhje me lehtesirat,kush hyn invalidet?Ditmira sqaron sipas ligjit.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim raporti i vleresimit dhe parashikimit te te ardhurave 2022-2024 dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

6.Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.68 date 28.08.2020 “Per shpronësimin,per interes publik te pasurive te paluajtshme prone private,qe preken nga projekti “Per ndertimin e banesave per strehim social,Roskovec”.

Dr.Juridike sqaron projektin.Kemi paraqitur nje ndryshim te listes se bashkepronareve e cila ka ardhur si pasoje e shkreses se ASHK-se,e cila na ka derguar nje shkrese te dyte.Pra kemi ndryshuar vetem listen e bashkepronareve sipas shkreses se ardhur.Hidhet ne votim projekti i ndryshimit te Vendimit Nr.68 date 28.08.2020 sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro (3/5+1)vota pro.

7.Per miratimin e Rregullores “Per kushtet dhe rregullat e zenies se hapsires publike ne Bashkine Roskovec”.

Sp.Urbanistikes sqaron projektin,sqaron rregulloren e zenies se hapsires publike te Bashkise Roskovec,afatet ligjore te dhenies se lejes,tarifat dhe kushtet e perdorimit te lejes se zenies se hapsires publike per ambulancet,kioskat.Sqaron sesi nje qytetar duhet te bej kerkese per leje dhe dokumentat qe duhet te dorezojne ne bashki per te aplikuar.Sqaron ne menyre te detajuar.Genci-sa kioska do jene dhe ku mund te jene keto kioska?Juristja shpjegon se do behet ne fillim nje studim se ku mund te vendosen.Kryetarja e bashkise sqaron ne lidhje me kioskat.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro rregullorja per kushtet dhe rregullat e zenies se hapsires publike ne Bashkine Roskovec.

8.Per miratim dhe transferim fondesh ne Buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2021.

Dr.Finances sqaron projektin sipas zerave te paraqitur ne materjal.Sqaron pikat sipas radhes ne menyre te detajuar.Nuk kemi shtese buxheti por transferim.Dr.Finances sqaron edhe shkresen e Ministrise se Financave per fondin e pagave dhe sigurimeve shoqerore per arsimin parashkollor e cila erdhi pasi ishin shperndare materialet e keshillit dhe do e fusim sot shtese kete fond per arsimin parashkollor.Kryetarja sqaron fondin e shpronësimeve i cili ka lidhje me SMT-ne, jo me bllokun nr.1.Hidhet ne votim projekti per miratim dhe transferim fondesh ne buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2021 bashke me shtesat e bera si me sipër dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

9.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Kryetarja-informacion ne lidhje me ankesat qe kane banoret me demshperblimin.Ju e dini se proceduren e ka bere Enti i Banesave.I kemi mirepritur te gjitha ankesat dhe i kemi referuar keto ankesa ne qeveri per nje rishikim te VKM-se.Nese ka te tjere qytetare per ankesa i ftoj ta bejne.Ne kemi marr nje thirrje nga qeveria per permiresimin e banesave te familjeve ne nevojë.Kontrolli qe

po bejme tani me komision nuk ka lidhje me demshperblimet, komisioni i Bashkise nuk verifikon dot VKM-ne e qeverise. Ky komision do hartoje projektin per shtepite qe kane nevojte per riparim, jo per demshperblimet e banoreve te Nj. Ad. Kuman. Leksi-fondi qe ka qene ka fuqi prapavepruese per ato shtepi qe kane ngelur ngjysem si rasti i Arti Hoxhes? Kryetarja-rasti i tij eshte abuziv, do shikojme emrat dhe verifikimet qe ka bere komisioni. Une sdo le nje familje e cila eshte shume ne nevojte dhe te kthehemi prape tek e njejta familje. Elmazi-ky fond eshte i qeverise jo i bashkise, e drejta e vendosjes eshte e bashkise. Ju te bashkise do veni shtepi me shtepi, selektiv nuk duhet te jeni, komisioni ti shoh ne menyre te barabarte pa bindje partiake. Kane ngelur disa nga hera e pare, rishikojini dhe i ndihmoni. Kryetarja-ne kemi shkuar tek ata qe kane bere kerkesa dhe ankesa ne bashki. Komisioni ne baze te ketyre kerkesave ka shkuar ne shtepite e tyre per verifikim. Nese qytetari nuk kerkon me shkrim jo me goje, ne skemi si ta dim, duhet te paraqitet qytetari te bej kerkesa. Nese nga lekundjet ka ndonje familje shume te demtuar, ne do e shohim. Elmazi-rruga midis Gramoz Çepeles eshte shembur, ju lutem e verifikoni. Genci-shoh nje pike skrapit e cila eshte ne qender te Roskovecit, e cila nuk shkon me gjithte keto rregullime qe jane bere dhe investime ne qender. Kryetari i keshillit-kerkon informacion ne lidhje me rekomandimet e KLSH-se per mungesat e keshilltareve. Genci-vendosja e barrierave tek rruga e unazes sepse eshte burim aksidenti, makinat ecin shume shpejt. Kryetarja-per mungesat e keshilltareve dhe rekomandimet e KLSH-se akoma sme ka ardhur informacioni me shkrim, per problemin e pikes se skrapit duhet bere ankese me shkrim. Nuk ka me pyetje. Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

